www.legjislacioni.gov.al

# Buletini i Njoftimeve Zyrtare

# I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 10

**Tiranë – E hënë, 10 prill 2017**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Njoftim i Ministrisë së Financave nr. 4431, datë 31.3.2017 | Për shitje......................................................................................... | 3 |

**MINISTRIA E FINANCAVE**
**Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike Tiranë**

**NJOFTIM I MINISTRISË SË FINANCAVE NR. 4431, DATË 31.3.2017**

**PËR SHITJE**

**Njofton se:**

Mbështetur në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", në VKM Nr.230, datë 04.04.1998 të ndryshuar, pika 9, në shkresën e Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Nr.1102/4, datë 13.03.2017, "Dërgohet dokumentacioni i vlerësimit të pjesëvë të kapitalit të zotëruar nga shteti, në shoqërinë me kapital të përbashkët "Euroteorema Peqin" sh.p.k." që përbëjnë 30 % të pjesëvë të kapitalit të vetë të shoqërisë", shpall për shitje pjesën e kapitalit shtetëror në shoqërinë sipas tabelës:

| Nr | Emri i Shoqërisë (Shp.k.) | Selia e Shoqërisë | Përqindja e kapitalit të zotëruar nga shteti që ofrohet për shitje ( % ) | Vlera minimale e pjesës së kapitalit të zotëruar nga shteti që ofrohet për shitje ( në lekë) | Objekti i veprimtarisë | Zhvillimi i ankandit | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Data | Ora | Vendi |
| 1 | "Euroteorema Peqin" sh.p.k. | Fushë MËZEZ T I R A N Ë | 30 | 72 879 415 | Ushtrim të ndërmarrjes ndërtues, aktivitet të transportit të mallrave brenda dhe jashtë vendit, drejtim shërbimesh publike etj. | 25.04.2017 | 10.00 | DDPP Tiranë |

Në këtë shoqëri me kapital të përbashkët pjesa prej 70 % zotërohet nga ortakët joshtetëror, (EUROTEORERMA - PEQIN SH.P.K.)
Të gjithë personat fizikë ose juridikë të interesuar për blerjën e pjesëvë të kapitalit të zotëruar nga shteti duhet të paraqesin në datën, orën dhe vendin e zhvillimit të ankandit, sa vijon:

**I**- Kërkesën me shkrim për blerje të rregjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave e cila duhet të përmbajë:

1. Emrin dhe adresën e saktë të subjektit fizik apo juridik që dëshiron të blejë pjesët e kapitalit të zotëruara nga shteti.
2. Dokumëntin bankar që vërteton pagesën paraprake 20 % të vlerës së publikuar për blerje në lekë; mandat arkëtimi ose garanci bankare për ngrirjen e shumës prej 20 % për llogari të Ministrisë së Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike në çdo Bankë të nivelit të dytë në llogarinë respektive të hapur për Ministrinë e Financave. Ngurtësimi do të bëhet pasi të jetë tërhequr nga Ministria e Financave (Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike) ose degët e thesarit në rrethe, Fatura për Arkëtim e plotësuar dhe e nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

**II.** Kërkuesi për blerjen e kuotave të publikuara për shitje duhet të paraqitet para komisionit të ankandit me dokumentin e identifikimit (pasaportë biometrike, letërnjofim, etj.)

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

**Tiranë, 2017**